



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

**FAKULTETI EKONOMIK**

Nr. 203/prot.

Shkodër, më 13.11. 2019

**MBLEDHJE E GRUPIT TË PUNËS**

**PROJEKTI Erasmus+ "MARDS"**

**Tema: Aprovimi i raportit të progresit të projektit Erasmus+ "MARDS" për vitin 2019 dhe rekomandimet e tij.**

Në mbledhjen e datës 13.11.2019 me prezencën e anëtarëve të grupit të punës të projektit MARDS:

Prof.as.dr.Blerita Dragusha

Prof.as.dr.Brilanda Bushati

Prof.as.dr.Ardita Boriçi

Prof.as.dr.Elidiana Bashi

Prof.dr.Arjeta Troshani

Prof.as.dr.Mirjam Dibra

Prof.dr.Fatbardha Molla

Prof.as.dr.Ermira Kalaj

Fatbardha Myrtja

u prezantua nga Prof.dr.Arjeta Troshani – kordinatore e projektit rapporti i progresit të projektit Erasmus+ "MARDS" për vitin 2019 me grupin e punës.

Gjatë vitit të parë të projektit (15 nëntor 2018-15 nëntor 2019) janë realizuar këto aktivitete kryesore:

- Hartimi i dy raporteve:

- Raporti i situatës së arsimit doktoral në Mal të Zi dhe Shqipëri në krahasim me praktikat e BE-së hartuar nga prof. Melita Kovacevic dhe Vesna Cavic nga Universitetit I Zagrebit dhe Prof. Lucas Ziner nga Universiteti i Vjenës.



-Raport mbi financimin e studimeve doktorale në Mal të Zi dhe Shqipëri hartuar nga prof. Predrag Miranovic nga Universiteti i Malit te Zi.

- Mobilite të stafeve akademike dhe administrative në sherbim të mësimdhënies.
- Sigurimi i paisjeve në shërbim të zbatimit të projektit.
- Promovimi i projektit.

Raporti bazuar në një sondazh që është bërë në kuadër të projektit MARDS ka pasë si qëllim analizën në drejtim të krijimit të kapaciteteve në fushën e studimeve doktorale në Mal të Zi dhe Shqipëri, dh të krijimi të Shkollave të Doktoraturave të Përbashkëta. Sondazhi i bërë me vendet partnere përbëhet nga shtatë tema:

- kuadri ligjor
- udhëzime rregulllore
- strategji dhe vizioni
- të dhënat statistikore
- strukturën e arsimit
- përzgjedhja e pranimi
- supervizorët

Është bërë analiza e të gjitha informacioneve të marra nga Universitetet partnere te projektit MARDS dhe janë përgatitur dhe 2 raportet. Mungesa e kuadrit ligjor përbën një pengesë serioze dhe po lobohet me përfaqësuesit e MASR që edhe janë pjesë e këtij projekti por që vahzdimi i kësaj situate mund të shkaktojë edhe dështimin e projektit. Ka një vonesë nga MAS në kthimin e përgjigjeve dhe indiferencë edhe nga Rektori i USH-së që duhet të ishte prezent të paktën në një nga mbledhjet e grupit të punës të projektit MARDS meqenësë është edhe pjesë e grupit të punës. Një rëndësi të madhe është sigurimi i cilësisë së doktoraturës që do hapet sepse ky aspekt u konsiderua shumë i rëndësishëm në të gjitha trajnimet e stafeve akademike gjatë vitit të parë të projektit. Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për arsimin e doktoraturës. E rëndësishme është krijimi i një procesi ndërkombëtarizimi dhe në vecanti të arsimit doctoral ku UNISHK duhet të sigurojë sa më shumë marrëveshje dhe bashkëpunime me Universitetet Perëndimore në Europë dhe SHBA. Çdo temë doktorature duhet të jetë në fokus të biznesit jo teorike dhe mbetet një sfidë se sa janë bizneset të interesuara për këto tema dhe këtu po punohet për sigurimin e marrëveshjeve midis UNISHK dhe komunitetit të biznesit. Ka një interes të veçantë nga studentët e degës Financë-Kontabilitet dhe të gjitha degëve të tjera të Fakultetit Ekonomik. Kordinatorja e projektit prof.dr.Arjeta Troshani thekson faktin se doktoratura në Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm që në hartimin e aplikimit është konsideruar si një doktoraturë ndërdisiplinare ku jo vetëm që duhet të përfshijë fushat e kërkimit të 3 specialiteteve të Fakultetit Ekonomik por edhe nga Shkencat Shoqërore, Shkencat Natyrore e të tjera fusha ku vetë sektorë i turizmit me një prespektivë shumë të mirë për vendin tonë e krijon mundësinë për të përfshirë shumë specialitete. Përveç kësaj duhet të angazhohen në këtë doktoraturë si udhëheqës nga profesorati i të gjitha Fakulteteve të USH që tradicionalisht edhe jepin mësim në Fakultetin Ekonomik.

Problematikë është çeshtja e financimit ku edhe njëri nga raportet e projektit MARDS e ka analizuar këtë problemaqë duke dhënë edhe rekomandimet e konkluzionet e ekspertëve që e kanë hartuar atë.

Nuk është realizuar deri tani transferimi i fondeve në llogarinë e universitetit. Kjo ka sjellë vonesë në kryerjen e tenderit të paisjeve dhe shpenzimeve tjera të bëra gjatë vitit të parë të projektit , udhëtime e kostot e stafit. Është kërkuar nga Administratorja e UNISHK znj. Erikliida Shpori mbi bazën e udhëzimeve nga Ministria e Financave hapja e dy llogarive, një



llogari në Bankën e Shqipërisë e një llogari në një bankë të nivelit të dytë. Për cështjet e menexhimit financiar të projektit sipas detyrave me të cilat ju ngarkon edhe ligji po punojnë Administratorja e UNISHK znj. Eriklida Shpori dhe financierja e projektit znj. Saida Bizaku. Raportet financiare që lidhen me projektin MARDS duhet të hartohen prej tyre dhe të informohet i gjithë grapi i punës për ecurinë.

Projekti kërkimor i doktoraturës bazohet në lëndët bazë dhe lëndët me zgjedhje sipas aplikimit të projektit.

Lëndët bazë:

1. Planifikimi Strategjik i Avancuar i Destinacioneve të Turizmit
2. Ekonomia e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
3. Metodat e Përparuara të Kërkimit.
4. Menaxhimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Lëndët me zgjedhje:

1. Menaxhimi i Biodiversitetit
2. Menaxhimi i Projektit në Turizëm
3. Sistemet e Informacionit në Turizëm
4. Sipërmarrja Sociale dhe Inovacioni.

Pritet që në lidhje me këtë kurrikul të japid mendime edhe nga partnerët e tjera të projektit dhe eksperte prandaj po punohet përfundimin e saj.

Në mbledhjen e Bordit të Drejimit të Projektit MARDS që do mbahet në Universitetin e Vjenës me datë 10-13 Dhjetor 2019 me pjesëmarrjen e prof.dr.Arjeta Troshani dhe prof.as.dr.Brilanda Bushati do merret edhe vendimi final për ecurinë e projektit në lidhje me problematikat e dala gjatë vitit të parë të tij.

Promovimi i këtij projekti është bërë në 25-vjetorin e FE, datë 2 nëntor 2018 dhe do të bëhet edhe në takimin me bizneset në fushën e turizmit, datë 18 nëntor 2019 në një takim që zhvillohet edhe përllogari të projektit FOST INNO.

Përveç rekomandimeve që i përban Raport Progresi i projektit MARDS Prof.as.dr.Elidiana Bashi rekomandoi që Fakulteti dhe Senati i UNISHK duhet të punojnë përgatitjet e Komisioneve të Përherëshme sipas Ligjit të Arsimit të Lartë.

Prof.dr.Arjeta Troshani kërkoi informacionin nga të gjitha strukturat në nivel Departamenti, Fakulteti, Senati apo Rektorati nëse do ketë udhëzime apo akte nënligjorë që do dalin nga MASR ashtu si edhe marrjen e masave përgatitore për procesin e aplikimit që po përgatitet në kuadër të këtij projekti.

**Progres raporti i vitit të parë të projektit MARDS dhe rekomandimet që dalin prej tij u aprovuan unanimisht nga grapi i punës prezent në këtë mbledhje.**

**KORDINATORE**

*Arjeta Troshani*

Prof.dr. Arjeta TROSHANI

**DEKANIA**

Prof.as.dr. Blerta DRAGUSHA

